

STATUT I SHOQERISE
"Gjebrea Construction" shpk.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 01 / 09 / 2023, personat e mëposhtem:

1. **Eno Gjebrea**, shtetas shqiptar, i biri i Ilirit dhe Donikës, i ditëlindjes 27.7.1982, lindur e banues në Tiranë, me adresë Rr. Todi Shkurti, Nd. 13, H. 4, Ap. 42, Njesia Administrative nr. 2, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 037935444, dhe
2. **Romina Lula**, shtetase shqiptare, e bija e Andreas dhe Valentinës, e ditëlindjes 16.5.1980, lindur e banuese në Tiranë, me adresë Rr. e Dibrës, Nd. 68, H. 7, Ap. 10, Njesia Administrative nr. 8, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 038944692,

ne përputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë, miratuan këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" është ky Statut i Shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 01 / 09 / 2023, ne, themeluesit e mësipërm, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar "Gjebrea Construction" shpk.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: **Aktivitet në fushën e ndërtimit, ndërtime industriale, civile e ekonomike, ndërtime dhe rindërtime e rikonstruksion i objekteve civile e industriale, veprave të infrastrukturës etj. pa kufizim. Planifikimi, projektimi, financimi, ndërtimi, testimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave. Import, eksport, shitje me shumice e pakice të pajisjeve industriale dhe të materialeve të ndërtimit, artikujve hidrosanitare, mobilie, lenden e pare apo mallra të përfunduara, duralumine, punime druri, plastike etj. Tregtimi me shumice e pakice i çdo lloj malli të lejuar sipas legjislacionit shqiptar, mallra ushqimore dhe jo ushqimore pa kufizim. Shërbime delivery (dorëzimi në adrese) të mallrave dhe porosive. Të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme, të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënieje apo hipotekimi, të cilat mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për arritjen e objektivit të shoqërisë. Të blejë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë interesa në shoqëri të tjera tregtare, në Shqipëri apo jashtë saj; dhe çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për realizimin e objektivit të Shoqërisë.**

Neni 3
Kohëzgjatja



Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e **pacaktuar dhe/ose e pakufizuar**.

Neni 4 Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Rr. Tefta Tashko Koco, nr 63, ndërtesa nr. 12, shkalla 1, ap. 4, ZK 8150, pasuria me nr. 5/299+1-4, Tiranë, Shqipëri.**

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **LEK 100 (njëqind lekë)**. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Eno Gjebrea**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50 LEK që përben **50% të kapitalit themeltar të shoqërisë**.
2. Ortaku themelues **Romina Lula**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50 LEK që përben **50% të kapitalit themeltar të shoqërisë**.

Kontributi i ortakëve është në para dhe do të shlyhet prej tyre menjëherë me themelimin e shoqërisë.

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe te shoqëritë kontrolluese dhe/ose te grupit te caktuara me vendimin e Asamblesë. Pjesët e kapitalit mund te kalohen te te tretet vetëm me miratimin e Asamblesë se Përgjithshme, qe jepet nëpërmjet nje vendimi të mare me unanimitet. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjithë apo nje pjese te kuotes se tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, secili prej Ortakeve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi te gjithë apo nje pjese te kuotes ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesi te faktit se sa ortake do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me proceduren ne vijim. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjithë apo nje pjese te kuotes se tij, ai, perpara se te nënshkruaje marreveshje me persona te ndryshem nga

Ortakët, do të njoftojë me shkrim Administratoret për transferimin e planifikuar, duke përcaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at të cilëve planifikon t'u transferojë kuotën dhe kushtet esenciale që do të aplikohen për transferimin. Administratoret, brenda 10 ditëve duke filluar nga dita kur është njoftuar nga Ortaku për shitjen apo transferimin e planifikuar, do të informojnë me shkrim Ortakët e tjerë. Secili prej Ortakëve që ka të drejta parablerjeje, brenda 1 (një) muaji nga njoftimi prej Administratoreve për shitjen apo transferimin e planifikuar, do të njoftojë me shkrim Administratoret nëse ka qellim të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes. Administratoret brenda 10 ditëve nga marrja e këtij njoftimi do të njoftojnë me shkrim Ortakun që dëshiron të transferojë kuotat e tij. Nëse me shumë se një Ortakë ushtrojnë të drejtat e parablerjes së kuotës, ata do të blejnë kuotën në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre aktuale në kapitalin themelues. Nëse asnjë njoftim nuk është dhënë nga ndonjë Ortakë si më sipër, Ortaku që ka për qellim të transferojë kuotën e tij do të jetë i lire t'ia transferojë këtë kuotë personit/ave të përcaktuar prej tij. Nëse vetëm një Ortakë ka dhënë njoftim për qellimin e tij për të ushtruar të drejtën e parablerjes, ky Ortakë do të ketë të drejtë të blejë kuotën objekt transferimi brenda 10 ditëve nga data e mbarimit të afatit 1 (një) muajor të përcaktuar më sipër. Çdo transferim i kuotave që nuk kryhet në përputhje me parashikimet e këtij neni është i pavlefshëm dhe pa efekte për Shoqërinë.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme



Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve mbledhet ne rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe është e nevojshme për te mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mbledhet te paktën një here ne vit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortaket.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë se Përgjithshme mund te dërgohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqërisë me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i është dorëzuar Shoqërisë me kalimin e ditës se 7-te pas dërgimit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqërisë, seline, daten, kohën dhe vendin e mbledhjes, një pershkrim te hollesishem te procedurës qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesëmarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyrën e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithë Ortakeve, po ashtu edhe rendin e ditës, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te paktën 7 (shtate) dite para mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si me sipër duhet te përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve duhet te vendose për ndryshime te Statutit, teksti përkatës duhet te njoftohet se bashku me rendin e ditës.

Ortaket mund te marrin pjese ne mbledhjet e asamblesë se përgjithshme nëpërmjet mjeteve te ndryshme te komunikimit, përfshire mjetet e komunikimit elektronik, qe garantojnë identifikimin e ortakeve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Një Ortak mund te përfaqësohet ne Asamblesë e Përgjithshme te Ortakeve nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund te jepet vetëm për një mbledhje te Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me te njëjtin rend dite.

Te gjitha vendimet e Asamblesë duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje te tij.

Neni 10 Kuorumi

Me përjashtim te shkarkimit te administratorit, në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me unanimitet, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët,

përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përfshirimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i parë i shoqërisë me mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi caktohet Z. Eno Gjebrea, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 27.7.1982, lindur e banues në Tiranë. **Veç kufizime ligjore, kompetencat e administratorit Eno Gjebrea kufizohen si vijon: Administratori detyrohet të marrë miratimin e asamblesë së ortakëve për të shitur të gjithë aktivitetin e shoqërisë. Administratori detyrohet të marrë miratimin e asamblesë së ortakëve për të gjitha transaksionet që shkojnë përtej veprimtarisë normale të biznesit të shoqërisë. Transaksione të tilla konsiderohen në veçanti: blerja, shitja dhe barrësimi i pasurive të paluajtshme në pronësinë e shoqërisë; marrja përsipër si dhe dhënia e garancive dhe detyrimeve (hua / kredi); marrja e kredive edhe si bashkëkredimarrës; lidhja e kontratave dhe kryerja e transaksioneve me para në dorë dhe/ose bankare me vlerë të përgjithshme prej më shumë se 5.000.000 (pesë milionë) LEK ose ekuivalenti në monedhë të huaj pr kontrat / transaksion; lëshimi i prokurave dhe autorizimeve me përjashtim të prokurave të lëshuara për ortaken znj. Romina Lula.**

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të therasin Asamblesë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim a mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme: u kthen ortakëve kontributet; u paguan ortakëve interesa apo dividendë; u shpërndan aktivet shoqërisë; lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet



Neni 16
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17
Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 18
Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe: me vendim të Asamblesë se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës dhe për çdo rast tjetër te parashikuar ne ligj.

Nëse vendoset prishja e shoqërise ne gjendjen e aftësisë paguese, ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper". Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Neni 19
Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 20
Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërise.

Neni 21
Mosmarrëveshjet



Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te lindre midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua, nga ortakët themelues si vijon:

ORTAKËT THEMELUES

Eno Gjebrea

Handwritten signature of Eno Gjebrea in blue ink, consisting of a cursive name and a large, sweeping flourish below it.

Romina Lula

Handwritten signature of Romina Lula in blue ink, consisting of a cursive name and a stylized signature below it.